

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Golden key” SHPK**

Objekti i veprimitarisë së kësaj shoqericë është:

Në Tirane, sot me datë 19.7.2021, në selinë e shoqërisë, me zyre ne Rr Dervish Hima Ap 51 Nr 6/369+1-51 shkalla 1 kt 10, u paraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Znj. Bardhjus Bushaj**, shtetas shqiptar, atësia Luan, lindur më 10.05.1982 në Fier dhe banues në Tiranë, adresa Rr me adresë Rr.Seit Teqja 03950073; Nd. 116; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë”, madhor, me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar me leternoftim nr.034162474 dhe numer personal I20510034N.
2. **Z. Erion Gina**, atësia Agim, shtetas shqiptar, lindur më 24.04.1984 në Lushnje, dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.”Mullet Rolling Hills”, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar me leternoftim Nr. 035132918 dhe numer personal I40424036G

Të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë “**Golden Key**” SHPK, mbështetur në ligjin 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

**KREU 1**

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “**Golden Key**” SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

8. Ushtrimi e aktiviteteve si bar lokale, dbe furnizimin me produkte ushqimore dhe pije si aktivitet tregtar.

Ne ushtrimin e këtyre aktiviteteve kompania përfundon me vendore degë, zyra, agjencie dhe depo në të gjithë vendin si edhe jashtë vendit.

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), në përpunje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqëria “**Golden Key**” shpk, është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selinë në Tirane në adresën: Rr Dervish Hima Ap 51 Nr 6/369+1-51 shkalla 1 kt 10. Zk 8160 v32 fq 55

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

1. Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi; rrugë; ura; porte; trase hekurudhore; terminale; hidrocentrale; veprave bonifikuese; parkimeve nëntokësore dhe cdo ndërtim tjetër; punime ndërtimore në nëntokë dhe në lartësi.
2. Rikonstruksion i ndërtimeve civile dhe restaurime të objekteve historike, fetare dhe objekteve të tjera. Studim, projektim i ndërtimeve të ndërtesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese, centrale, objekte turistike, terminale, parkime nentokesore, industriale, objekte te kulteve, realizim te studimeve urbane, restaurime, prodhim te materialeve te ndertimit.
3. Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive te paluajtshme. Aktivitet ne menaxhimin e qendrave te biznesit; qendrave tregtare; terminaleve; porteve; aeroporteve; dhe sherbimeve te ngjashme.
4. Aktivitet ne fushen e financimit, investimit dhe menaxhimit te projekteve koncesionare; partneritet publik privat; partneritetit duke krijuar shoqeri te thjeshta; parteritet me shoqeri shqiptare dhe/ose te huaja.
5. Prodhim dhe Tregtim materiale ndertimi, inerte, rere, mermer, etj. Prodhim dhe tregtim makineri e pjesë kembimi per llojet e ndryshme te makinerive.
6. Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme e te paluajtshme , pjesëmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndërmarrje te tjera.
7. Blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve, bono, te letrave me vlore te borxhit publik dhe privat ne per gjithesi, te aksioneve ne kompani, letra me vlore, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive te paluajtshme.
8. Ushtrimin e aktiviteve si bar lokale, dhe furnizimin me produkte ushqimore dhe pije si aktivitet tregtar. Ne ushtrimin e ketyre aktiviteve kompania mund te perdore dege, zyra, agjenci dhe depo ne te gjithe vendin si edhe jashte vendit.
9. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet tregtare, ne fushen e pasurive te paluajtshme, financiare dhe industriale qe do te konsiderohen te nevojshme nga organi administrativ ose te dobishme per te arritur qellimin e shoqerise.
10. Shoqeria mund te kryeje transaksione financiare, dhe te pasurive te paluajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimit te shoqerise, te marre pjesë ne shoqeri te tjera me objekt te njejte, te ngjashem apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakeve dhe ne favor te te treteve.

**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**KREU II**  
**KAPITALI**  
Neni 6  
*Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë (njeqind mijë leke).

- Ortaku **Bardhjus Bushaj** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 50 000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.
- Ortaku **Erion Gina** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 50 000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7  
**Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**  
Neni 8  
*Organi Vendimmarres*

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financier kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9  
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator Z.Bardhjus Bushaj dhe Z.Erjon Gina **me identitetë si mësipër** sipas statutit dhe ligjit per një periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

- Administratorët e shoqerise do te veprojne te dy se bashku per çeshtje te rendesishme si marrjen e kredive, shitje, blerje ne emer te shoqerise, vendosjen e garancive hipotekore apo kuotave dhe pasurive te tjera te luajtshme te shoqerise.
- Administatoret do te veprojne të dy sëbashku per çeshtje te administrimit te zakonshem te shoqerise dhe veprime bankare ne numrat e llogarise te shoqerise, per transaksione bankere.
- Administratorët të dysëbashku përfaqësojnë shoqërinë përpara cdo personi fizik apo juridik, administratë shtetërore, përpara cdo zyre noterie, cdo institucioni bankar te nivelit të dytë, apo cdo institucioni tjeter ku do të kërkohet prania e shoqërisë në lidhje me administrimin *e saj*.
- Secili administrator vec e vec ka te drejte te paraqite ne QKB per regjistrimin e Vendimeve , autorizimeve prane QKB.(Ose cdo person tjeter i autorizuar prej tyre vec e vec)

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratorët të dy sëbashku kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administritimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruanë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbytjen e shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmbytjen e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administritimit të zakonshëm. Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshili këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat përmbytjen e vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoritetet e Doganit, etj, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj ne përputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14  
Dispozita perfundimtare


Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlarë me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "**Golden Key**" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES  
TË SHOQERISË "Golden Key" SHPK**

**Bardhjus Bushaj**



**Erion Gina**



Objekti i veprimitaritë së kësaj shoqërie është:

1. Aktiviteti në fushën e ndërtimeve civile, objekte të banimit dhe banimi; rrugë; uam; porte; trase hekurudhere; terminali; hidrocentralet; etj. Sipas kriterit të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, u hartua statuti i shoqerise me perqyegjesi te kufizuar me ortake themelues :

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"Golden Key" shpk**

Në Tirane, sot me datë 19.7.2021, ne respektim te keresave te ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, u hartua statuti i shoqerise me perqyegjesi te kufizuar me ortake themelues :

2. **Znj. Bardhjus Bushaj**, shtetas shqiptar, atësia Luan, lindur më 10.5.1982 në Fier dhe banues në Tiranë, adresë Rr me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 116; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, madhor, me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr.034162474 dhe numer personal I20510034N.
2. **Z. Erion Gina**, atësia Agim, shtetas shqiptar, lindur më 24.04.1984 në Lushnje, dhe banues në Tiranë, me adresë Rr."Mullet Rolling Hills", madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar me letërnjoftim Nr. 035132918 dhe numer personal I40424036G

Te cilet hartoje kete statut te shoqerise "**Golden Key" shpk**", mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

**KREU I**

Neni 1  
Krijimi

Shoqeria "**Golden Key" shpk**", eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perqyegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Shoqeria mund te krijoje trupat e saj, qëndra, filiala, përgjigjen përmes aktiviteteve së harlokale, qëndruese, me produkte ushqimore dhe pije si aktivitet tregtar. Ne ushtrimin e këtyre aktiviteteve kompania mund te perdore degë, zyra, agjenci dhe depo ne te gjithe qellimin e shoqerise.

Kontributet e ortakeve përbëjne kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj per nje periudhë prej 10 vjetësh, duke filuar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Shoqeria e ka selinë në Tirane, ne adresen Rr Dervish Hima Ap 51 Nr 6/369+1-51 shkalla 1 kt 10 ZK8160 v32 fq55

Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimitarise

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

1. Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi; rrugë; ura; porte; trase hekurudhore; terminale; hidrocentrale; veprave bonifikuese; parkimeve nëntokësore dhe cdo ndërtim tjetër; punime ndërtimore në nëntokë dhe në lartësi.
2. Rikonstruksion i ndërtimeve civile dhe restaurime të objekteve historike, fetare dhe objekteve të tjera. Studim, projektim i ndërtimeve të ndërtesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese, centrale, objekte turistike, terminale, parkime nentokesore, industriale, objekte te kulteve, realizim te studimeve urbane, restaurime, prodhim te materialeve te ndertimit.
3. Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive te paluajtshme. Aktivitet ne menaxhimin e qendrave te biznesit; qendrave tregtare; terminaleve; porteve; aeroporteve; dhe sherbimeve te ngjashme.
4. Aktivitet ne fushen e financimit, investimit dhe menaxhimit te projekteve koncesionare; partneritet publik privat; partneritetit duke krijuar shoqeri te thjeshta; parteritet me shoqeri shqiptare dhe/ose te huaja.
5. Prodhim dhe Tregtim materiale ndertimi, inerte, rere, mermer, etj. Prodhim dhe tregtim makineri e pjese kembimi per llojet e ndryshme te makinerive.
6. Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme e te paluajtshme , pjesëmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndërmarrje te tjera.
7. Blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve, bono, te letrave me vlore te borxhit publik dhe privat ne per gjithesi, te aksioneve ne kompani, letra me vlore, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive te paluajtshme.
8. Ushtrimin e aktiviteteve si bar lokale, dhe furnizimin me produkte ushqimore dhe pije si aktivitet tregtar. Ne ushtrimin e ketyre aktiviteteve kompania mund te perdore dege, zyra, agjenci dhe depo ne te gjithe vendin si edhe jashte vendit.
9. Shoqeria mund te permbshe te gjitha operacionet tregtare, ne fushen e pasurive te paluajtshme, financiare dhe industriale qe do te konsiderohen te nevojshme nga organi administrativ ose te dobishme per te arritur qellimin e shoqerise.
10. Shoqeria mund te kryeje transaksione financiare, dhe te pasurive te paluajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimit te shoqerise, te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekt te njejte, te ngjashem apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakeve dhe ne favor te te treteve.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000lekë (njeqindmije leke).

1. Ortaku Bardhjus Bushaj është zoterues i nje kuote me vlore nominale 50 000leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.
2. Ortaku Erion Gina eshte zoterues i nje kuote me vlore nominale 50 000leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkuhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

### Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- ç)dhurimit;
- d)çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e

kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion finanziar.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 10 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 11 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të

kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregatre”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në kete nen, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 12 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendlod me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendlod me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen epasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### NENI 13 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e përgjithshme merr vendim per:

- a. vleresimin e veprimtarise se tij,
- b. shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
- c. ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç. Dhenien ose jo te perfitimeve te reja;

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes i ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### Neni 14 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga Shoqeria do te administrohet nga dy administrator Z. **Bardhjus Bushaj** dhe Z. **Erion Gina** me identitet si mësipër sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritej.

- Administratorët e shoqerise do te veprojne te dy se bashku per çeshtje te rendesishme si marrjen e kredive, shitje, blerje ne emer te shoqerise, vendosjen e garancive hipotekore apo kuotave dhe pasurive te tjera te luajtshme te shoqerise.
- Administratorët do te veprojne të dy sëbashku per çeshtje te administrimit te zakonshem te shoqerise dhe veprime bankare ne numrat e llogarise te shoqerise, per transaksione bankere.
- Administratorët të dysëbashku përfaqësojnë shoqërinë përpara cdo personi fizik apo juridik, administratë shtetërore, përpara cdo zyre noterie, cdo institucion i bankar te nivelit të dytë, apo cdo institucion i tjeter ku do të kërkohet prania e shoqërisë në lidhje me administrimin *e saj*.

- Secili administrator vec e vec ka te drejte te paraqite ne QKB per regjistrimin e Vendimeve , autorizimeve prane QKB.(Ose cdo person tjeter i autorizuar prej tyre vec e vec)

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 15  
*Kompetencat*

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejë detyrat e tjerat përcaktuara në ligjdhënë statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoritetet e Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhënet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

## Neni 16

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale osesolidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- c) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 18  
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakeve vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 19  
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvejtor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perbatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

### Neni 20

Të ardhurat neto qe mbeten pas vecimit të fondevi ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

### Neni 21

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, ligjt.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistanca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpëra vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendor në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korriguar, nëse është e mundshme të korrigohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkësës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji

### Neni 22

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvëçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtijligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

### Neni 23

#### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 24  
Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kérkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 25  
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërise ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 26  
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhënet ndërmjet shoqërise, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 27

Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 28  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 30  
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "**Golden Key**" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKET THEMELUES  
TE SHOQERISE "Golden Key" SHPK**

**Bardhjus Bushaj**

**Erion Gina**

